



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

C.nr.598/18

GJYKATA THEMELORE NË PEJË,- Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtar Ilir Berisha në çështjen juridike kontestimore të paditësit : Arben Lulaj nga Peja, të cilin e përfaqësohet nga Luan Lulaj nga Peja, rr. “Meto Bajraktari”, p.nr., kundër të paditurës : Fehima Kojiq nga Peja, rr. “Meto Bajraktari”, tani me vendbanim te panjohur, baza juridike: vërtetim pronësie, jashtë seancës me datë: 03.02.2022 bie këtë:

A K T V E N D I M

Të paditurës Fehima Kojiq nga Peja, rr. “Meto Bajraktari”, tani me vendbanim te panjohur, ia cakton përfaqësuesin e përkohshëm av. Fellenza Cacaj nga Prishtina.

Përfaqësuesi i përkohshëm është i obliguar që ti mbrojë dhe përfaqësoi interesat e të paditurit deri sa i njëjti të paraqitet personalisht në gjykatë apo përfaqësuesi me prokurë i tij gjegjësisht deri sa Qendra për Punë Sociale në Pejë, ta njoftoi gjykatën se të njëjtit i është caktuar një kujdestar.

Ky aktvendim do të publikohet në Gazetë Zyrtare të Republikës së Kosovës, Gazetën Koha Ditore, do të afishohet në tabelën e shpalljes së gjykatës dhe do të njoftohet QPS në Pejë.

Shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm i bartë paditësi

A r s y e t i m

Paditësit në këtë gjykatë me datë: 13.06.2018, ka parashtruar padi kundër të paditurës, për vërtetim pronësie, vlera e kontestit 2.500€,

Gjykata për të krijuar kushte procedurale sipas detyrës zyrtare në këtë çështje juridike, të paditurit, tani me adresë të panjohur, ia caktohen përfaqësuesin e përkohshëm av. Fellenza Cacaj nga Prishtina, në kuptim të dispozitave të nenit 79 par.3 pika a) dhe b) , nenit 81 ,82 dhe 83 te LPK/së.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË,
C.nr.598/18 të dt. 03.02.2022**

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet e drejta e ankesës.

Gjyqtar:
Ilir Berisha